

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"HUDSON ALBANIAN GROUP" SH. P. K.

Sot, më datën 15/01/2021, Z. Bujar Mersini, i ditëlindjes 14 Janar 1942, banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosi të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "**HUDSON ALBANIAN GROUP**" Sh. P. K. si më poshtë vijon

Neni 1

Z. Bujar Mersini, me vullnetin e tyit të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin "**HUDSON ALBANIAN GROUP**".

Administrator i kësaj shoqërie caktohet Z. Bujar Mersini per një periudhe deri ne 3 vjet. Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria "**HUDSON ALBANIAN GROUP**" gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Sh. P. K.". Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë është në Durrës, "Lagjja 1, Rruga Egnatia, Nd.137, H.3, Ap.22, 2025"

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënët të përcaktuara.

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe deri ne 31/12/2030.

Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitet me objekt:

- Menaxhimin e shërbimeve dhe të strukturave portuale të të gjitha tipeve, aktivitetet e tregtisë detare, si dhe ato që lidhen me to.
- Ushtrimin e të gjithë veprimtarive të shërbimeve detare dhe portuale të anijeve e mjeteve off-shore, në portet dhe ujërat kombëtare dhe ndërkombëtare, të tillë pa kufizim, si rimorkimi i mjeteve lundruese, shpëtimi i jetës dhe anijeve në det, shërbimet e sigurisë dhe mbrojtjes ndaj zjarrit, shërbimet e lidhjeve-zgjidhjeve të anijeve, atë të pilotimit të tyre, aktivitetet e agjensisë detare dhe spacionere,

doganore, tërheqjen e mbeturinave të ngurta, vajore dhe të lëngshme nga anjet, shërbimet kundër ndotjes së porteve dhe të hapësirave detare, shërbimet e sigurisë (Safety) në porte dhe radë.

- Ndërmarrjen e zbatimin e kontratave publike dhe private për ushtrimin e shërbimeve në aktivitetet që kryhen në ujërat detare kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Transportin detar të pasagjerëve dhe mallrave të të gjitha llojeve dhe strukturave me mjetet e veta apo të çarteruara.
- Trajnimit të detarëve dhe të drejtuesve të mjeteve të lundrimit në përputhje me standarde ISO: 9001:2015, zhvillimin e kurseve detare & operatorëve të industrisë detare.
- Punime të të gjitha kategorive të veprimtarisë detare dhe ujore, inpektimë nënüşore dhe kryerjen e matjeve batimetrike të reliefëve nënüşorë detarë.
- Shërbimet për tërheqjen e grumbullimin e mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme të mjeteve lundruese dhe anijeve, në porte, det të hapur apo në spirancë në rada.
- Shërbimet e mirëmbajtjes së aseteve dhe objekteve portuale, në marina dhe të sipërfaqeve ujore të tyre.
- Shërbimin e dhënies së asistencës anijeve në det, platformave lundruese dhe kërkimore, për nxjerrjen e hidrokarbureve, pontoneve, qofshin ato fikse apo të lëvizshme.
- Shërbime kantieri për mirëmbajtjen e mjeteve detare, të ndërtimit të anijeve dhe gjithë tipave të mjeteve lundruese.
- Shoqëria mund të kryejë të gjitha llojet e veprimtarive tregtare, të import-exportit, në pronat e luajtshme e të paluajtshme, që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimeve ekonomike të saj; ajo gjithashtu mund të marrë pjesë në investime në shoqëri e biznese të tjera të tretëve, si dhe të sigurojë fonde nga palët e treta për securinë e qëllimeve të përbashkëta të shoqërisë.
- Të realizojë veprimtari dhe menaxhimin e instalimeve, impianteve dhe teknologjive të ndryshme në fushën e industrisë detare.
- Prodhime impiantesh për aktivitetet petroliferike, administrimin, menaxhimin e shpërndarjen e prodhimeve të naftës e gazit.
- Të hulumtojë dhe industrializojë teknologji të reja, sisteme bashkëkohore dhe pajisje, që lidhen me veprimtarinë detare, portuale, të ndërtimit të anijeve të të gjitha llojeve e tipave, si civile, ashtu edhe ushtarake.
- Të ushtrojë aktivitetin e rekomandimeve të tregtisë detare dhe të angazhohet drejtpërdrejt, me veprimet e nevojshme operative dhe administrative në shërbim të pronarëve të anijeve dhe për llogari të tyre, si vendas, ashtu edhe të huaj.
- Pjesëmarrje në investimet industriale dhe tregtare, si dhe në aktivitete të ndryshme financiare, tregtare e industriale.

Neni 5

Kapitali i shoqerise eshte 10.000 Leke, i ndarë në 1 kuotë

Z. **Bujar Mersini** zotëruar i një kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme-apo te drejta). Ortaket per gjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijojen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

Neni 8


Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialat e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organinzipin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKU I SHOQËRISË

Bujar Mersini

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Bujar Mersini", is written over a large, thin-lined oval. The signature is fluid and cursive, with the name clearly legible within the oval.